- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë _____</b>                         |  |

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

| <i>1</i>                                  | <i>2</i>                     | <i>3</i> | <i>4</i>        | <i>6</i>                         |       |
|---|------------------------------|----------|-----------------|----------------------------------|-------|
| Artikulli                                 | Përshkrimi i shërbimit       | Sasia    | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim (3 x 4X) |       |
| 1.  |                              |          |                 |                                  |       |
| 2.  |                              |          |                 |                                  |       |
| 3.  |                              |          |                 |                                  |       |
| 4   |                              |          |                 |                                  |       |
|   | <b>Çmimi total (Mallrat)</b> |          |                 |                                  | _____ |
| <b>Çmimi Neto pa TVSH</b>                 |                              |          |                 |                                  |       |
| <b>TVSH (%)</b>                           |                              |          |                 |                                  |       |
| <b>Çmimi total me TVSH:</b>               |                              |          |                 |                                  |       |
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |                              |          |                 |                                  |       |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |                              |          |                 |                                  |       |

---

|                   |  |
|-------------------|--|
| <b>Vula</b>       |  |
| <b>Datë</b> _____ |  |



### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to**

## **SHERBIMI I PASTRIMIT NËNJËSITË ADMINISTRATIVENOVOSLË, QENDËR VLORË DHE SHUSHICË**

---

## **1. Kuadri Ligjor**

- 1. Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035, miratuar me vendim të keshillit të ministrave Nr. 418, datë 27.5.2020*
- 2. Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020*
- 3. Vendim i KM Nr. 319, Date 31.05.2018 per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve*
- 4. Drat Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve,, Bashkia Vlorë*
- 5. Ligj Nr. 7961, Dt 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar me ligjin nr. 9125, date 29.7.2003)*
- 6. VKM Nr. 113 Date 01.03.2023 “Per përcaktimin e pages minimale ne shkalle vendi”.*
- 7. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”*
- 8. ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”*




Figure 1. Harta e qytetit të Vlorës

## 2. Hyrje

Vlora është një qytet dhe bashki bregdetare në jug të Shqipërisë. Është vendi ku u shpall Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912. E themeluar si një koloni e lashtë greke në shekullin e 6 para Krishtit me emrin Aulon dhe e banuar vazhdimisht për rreth 26 shekuj, me një pozicion të favorshëm gjeostrategjik, Vlora është shtëpia e Portit të Vlorës dhe Universitetit të Vlorës si qyteti më i rëndësishëm ekonomik dhe kulturor i Shqipërisë jugperëndimore.

Largësia nga kryeqyteti, Tirana, është 135 km,

---

ndërsa nga Italia vetëm 72 km dhe nga Greqia 124 km.

Bashkia aktuale u formua pas zbatimit të reformës administrative-territoriale në vitin 2015, e cila bashkoi këto ish-njësi të qeverisjes vendore: Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë, Shushicë dhe Vlorë, të cilat u shndërruan në njësi administrative bashkiake. Bashkia e Vlorës ka një popullsi rreth 150,000 banorë dhe shtrihet në një sipërfaqe totale prej 617 kilometra katrorë. Bashkia shtrihet nga lumi Vjosë pranë Novoselës deri në Qafën e Llogarasë duke përfshirë tre qendra të rëndësishme të turizmit detar: Vlorën, Radhimën dhe Orikumin dhe parkun bregdetar Sazan–Karaburun, me më shumë se 90 km vijë bregdetare. Gjiri i Vlorës është i njohur për burimet e tij natyrore, biodiversitetin e pasur dhe korridoret ekologjike. Është ndër zonat me potencialin më të lartë turistik të vendit, me dalje direkte në det, me pasuritë natyrore, klimatike, ujore, arkeologjike-morfologjike, historike, kulturore, njerëzore dhe ekonomike.

Në Bashkinë e Vlorës veprojnë më shumë se 6,600 biznese, të cilat sjellin të ardhurat kryesore për buxhetin e bashkisë. Aktiviteti bujqësor është përqendruar tek blegtoria dhe ullinjët dhe si zonë bregdetare, Vlora është një qendër e rëndësishme e peshkimit. Sektori i turizmit është prioritar dhe katalizator i rritjes ekonomike, me një numër të lartë investimesh kryesisht në strukturat akomoduese. Numri i vizitorëve gjatë sezonit të verës bën që popullsia të shkojë drejt 300,000; dhe llogariten rreth 1.6 milion ditë qëndrimi të vitit. Në njësinë administrative Orikum ndodhen një sërë atraksionesh turistike si laguna e Orikumit, Rrapi 170 vjeçar i Tragjasit të Vjetër, Parku Kombëtar i Llogarasë prej 1,010 ha, qyteti antik i Orikut, kisha e Marmiroit që daton në shek. XII, Ujësjellësi i Ferrunit i shek. XIX, Gjiri e Gramatës, Kalaja mesjetare të Gjon Boçarit, Kulla e Dervish Aliut të shek. XIX. Pika tërheqëse për vizitorët në njësinë administrative Qendër janë kështjella e Kaninës, me gjurmë arkeologjike mijëra vjeçare, ishulli i Zvernecit dhe Manastiri i tij i periudhës bizantine dhe ishulli i Sazanit.

Plani i Zhvillimit të Vlorës 2017–30 është mjeti kryesor i planifikimit për të formësuar të ardhmen e qytetit. Bashkia synon të zhvillojë një turizëm të qendrueshëm ekologjik dhe kulturor që krijon mundësi punësimi dhe ruan ekosistemet. Për zhvillimin e tij duhet të përmirësohen dy aspekte

1) ofrimi i shërbimit sanitar kryesisht në zonat me tërheqje turistike dhe 2) mungesa e trajtimit të mbetjeve të ngurta.

Menaxhimi urban dhe infrastruktura bazë janë sfidat me të cilat përballlet bashkia sot, veçanërisht në shpërndarjen e shërbimeve për shkak të shtrirjes gjeografike. Qytetet e Vlorës

dhe Orikumit si dhe fshati Radhimë janë përfshirë përgjatë dekadës së fundit nga një bum ndërtimi, i cili ka krijuar mbingarkesë të infrastrukturës dhe probleme në mjedis dhe në menaxhimin e mbetjeve të ngurta.

### 3. Parashikimi i popullsisë

Prodhuesit e mbetjeve janë qytetarët, bizneset, institucionet publike dhe turistët. Gjatë dekadave të fundit, Bashkia Vlorë është karakterizuar nga lëvizje të mëdha demografike, të cilat shpjegojnë edhe diferencën e theksuar midis numrit të popullsisë së regjistruar në gjendjen civile dhe numrit të nxjerrë nga Censusi kombëtar. Bashkia Vlorë në tërësi përfshin dy qytete dhe 37 fshatra, përfshirë edhe Sazanin.

Të dhënat për popullsinë dhe zhvillimin e saj janë baza për llogaritjen e sasive aktuale dhe të ardhshme të mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara. Studimit Sektorial për Kërkesën për Investime për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta në Shqipëri (Vendim i KKT Nr.1, Datë 13.01.2020), citon metodologjinë për parashikimin e popullsinë dhe mbetjeveve siç përshkruhet në vijim. Kyparashikim të dhënat për popullsinë i bazohet në Census-in e Popullsisë dhe Regjistrin e Gjendjes Civile. Të dhënat e popullsisë nga Regjistri i Gjendjes Civile janë përgjithësisht shumë më të larta se shifrat sipas Census-it, dhe për këtë arsye, është zbatuar faktori i korigjimit i hartuar nga Ministria e Financave për të përafshuar shifrat e popullsisë:  $\text{Census} + (\text{Regjistri Civil Census}) * 30\%$ . Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e popullsisë sipas njësive administrative.

Tabela 1 Parashikimi i popullsisë për Bashkinë Vlorë, 2022–2035

| Viti | Parashikimi i popullsisë |              |          |        |
|------|--------------------------|--------------|----------|--------|
|      | Novoselë                 | Qendër Vlorë | Shushicë | Total  |
| 2022 | 10,974                   | 10,188       | 5,322    | 26,484 |
| 2023 | 11,004                   | 10,215       | 5,336    | 26,555 |
| 2024 | 11,034                   | 10,243       | 5,351    | 26,628 |
| 2025 | 11,064                   | 10,271       | 5,365    | 26,700 |
| 2026 | 11,094                   | 10,299       | 5,380    | 26,773 |
| 2027 | 11,124                   | 10,327       | 5,395    | 26,846 |
| 2028 | 11,155                   | 10,356       | 5,410    | 26,921 |
| 2029 | 11,185                   | 10,384       | 5,424    | 26,993 |

|      |        |        |       |        |
|------|--------|--------|-------|--------|
| 2030 | 11,216 | 10,413 | 5,439 | 27,068 |
| 2031 | 11,247 | 10,441 | 5,454 | 27,142 |
| 2032 | 11,278 | 10,470 | 5,469 | 27,217 |
| 2033 | 11,309 | 10,499 | 5,485 | 27,293 |
| 2034 | 11,341 | 10,528 | 5,500 | 27,369 |
| 2035 | 11,372 | 10,558 | 5,515 | 27,445 |

#### 4. Parashikimi i volumeve dhe përbërja e mbetjeve

##### 4.1. Parashikimi për gjenerimin e mbetjeve

Sasitë e grumbulluara të mbetjeve ndryshojnë nga shumat e gjeneruara të mbetjeve, për shkak se shërbimet e grumbullimit të mbetjeve nuk mbulojnë të gjitha zonat, veçanërisht në zonat rurale. Si rrjedhojë, për parashikimin e grumbullimit të mbetjeve, supozohen normat e grumbullimit të mbetjeve sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 2 Sasi të veçanta të gjenerimit të mbetjeve sipas llojit të vendbanimit

| Llojet e vendbanimeve  | Lloji N° | Gjenerimi i Mbetjeve [kg/cap/d] |
|--|----------|---------------------------------|
| Kryeqytetet me rëndësi kombëtare (qendra e qarkut, >35,000 banorë) | 12       | 1,1                             |
| Periferia (jashtë zonës metropolitane Tiranë–Durrës)               | 23, 24   | 0,55                            |
| Njësitë vendore jo-urbane të minierave ose energjisë               | 32       | 0,55                            |
| Fusha bujqësore të përziera  | 41       | 0,4                             |
| Malet e përziera bujqësore   | 42       |                                 |

Në tabelën e mëposhtme, parashikimi i gjenerimit të mbetjeve është përmbledhur në nivel bashkish. Gjithashtu, figura më poshtë tregon zhvillimin e gjenerimit të mbetjeve gjatë periudhës së planifikimit. Sasia ditore e mbetjeve per banorë sipas standarteve por edhe sipas experiencës së përfutur nga kontratat e mëparshme arrin 0.6 kg/banorë/ditë

Tabela 3 Parashikimi i gjenerimit të mbetjeve në bashkinë e Vlorës, sipas njësive administrative, 2022–2035 [t/v]

| Viti | Projeksioni i Gjenerimit të Mbetjeve Njësitë Administrative Novoselë, Qendër Vlorë, Shushicë |        |          |       |
|------|--|--------|----------|-------|
|      | Novosele   | Qender | Shushica | Total |
| 2022 | 2403t  | 2231t  | 1166t    | 5800t |



|      |       |       |       |       |
|------|-------|-------|-------|-------|
| 2023 | 2410t | 2237t | 1169t | 5816t |
| 2024 | 2416t | 2243t | 1172t | 5832t |
| 2025 | 2423t | 2249t | 1175t | 5847t |
| 2026 | 2430t | 2255t | 1178t | 5863t |
| 2027 | 2436t | 2262t | 1182t | 5879t |
| 2028 | 2443t | 2268t | 1185t | 5896t |
| 2029 | 2450t | 2274t | 1188t | 5911t |
| 2030 | 2456t | 2280t | 1191t | 5928t |
| 2031 | 2463t | 2287t | 1194t | 5944t |
| 2032 | 2470t | 2293t | 1198t | 5961t |
| 2033 | 2477t | 2299t | 1201t | 5977t |
| 2034 | 2484t | 2306t | 1205t | 5994t |
| 2035 | 2490t | 2312t | 1208t | 6010t |

## 5. Pastrimi i rrugëve, grumbullimi i mbetjeve dhe transporti i tyre

### 5.1. Njësia administrative Qendër

Në këtë njësi administrative janë të shpërndara 30 pika grumbullimi/ kontenerë. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve nga familjet dhe bizneset përgjatë bregdetit Nartë–Zvërnec kryhet çdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve mbulon një sipërfaqe prej 55,000 m<sup>2</sup> (sipas planimetrive përkatëse). Shërbimi në këtë Njësi Administrative kryhet me operator privat.

### 5.2. Njësia administrative Novoselë

Njësia administrative Novoselë ka të instaluara në total 43 kontenerë dhe 52 pika të tjera në hapësirën e 12 fshatrave, përkatësisht si në tabelën më poshtë.

Tabela 4 Numri i pikave të grumbullimit dhe distanca nga Vendepozitimi NjA Novoselë

| Fshati   | Distanca në km nga VD | Pikate Grumbullimit | Sipërfaqe që fshihet |
|----------|-----------------------|---------------------|----------------------|
| Novosele | 20km                  | 11pika              | 18,000m <sup>2</sup> |
| Dellenje | 34km                  | 6pika               |                      |
| Delisuf  | 32km                  | 8pika               | 5,600m <sup>2</sup>  |
| Bishan   | 24km                  | 10pika              | 8,000m <sup>2</sup>  |
| Poro     | 31km                  | 7pika               | 6,400m <sup>2</sup>  |
| Fitore   | 22km                  | 11pika              | 16,000m <sup>2</sup> |

|              |      |               |                             |
|--------------|------|---------------|-----------------------------|
| Mifol        | 16km | 6pika         | 200,000m <sup>2</sup>       |
| Akerni       | 13km | 8pika         |                             |
| Aliban       | 17km | 7pika         |                             |
| Skrofotine   | 15km | 6pika         |                             |
| Cerkovine    | 12km | 6pika         |                             |
| Trevllazer   | 7km  | 9pika         |                             |
| <b>TOTAL</b> |      | <b>95pika</b> | <b>254,000m<sup>2</sup></b> |

Punëtorët e pastrimit të operatorit privat grumbullojnë dhe largojnë mbetjet e lokaleve dhe familjeve cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj.

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve kryhet me krahë në një sipërfaqe totale prej 254,000 m<sup>2</sup> (sipas skicave përkatëse) në gjithë njësinë, cdo 3 ditë në javë

### 5.3. Njësia administrative Shushicë

Në 9 fshatrat e kësaj njësie administrative janë të shpërndara 40 pika kontenierë për grumbullimin e mbetjeve. Punëtorët e pastrimit pastrojnë dhe ngarkojnë në mjet mbetjet nga familjet dhe bizneset cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. Transportimi i mbetjeve kryhet drejt vendgrumbullimit kryesor të mbetjeve në Bashkinë Vlorë.

Pikat e grumbullimit në Njësinë Administrative Shushicë janë si më poshtë:

Tabela 5 Numri i pikave të grumbullimit dhe distanca nga Vendepozitimi NjA Shushicë

| Fshati    | Distanca në km nga VD | Pikate Grumbullimit |
|-----------|-----------------------|---------------------|
| Risili    | 7.1                   | 8pika               |
| Ceprat    | 9.5                   | 2pika               |
| Bunavi    | 11.8                  | 2pika               |
| Grabian   | 12.5                  | 3pika               |
| Llakatund | 13.5                  | 8pika               |
| Shushice  | 13.5                  | 7pika               |
| Mekat     | 15.5                  | 3pika               |

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve ofrohet vetëm në qendër të Njësisë Administrative, në një sipërfaqe prej 3200 m<sup>2</sup>.

## 6. Llogaritja e Kostos

Llogaritjet e kostove për këtë skemë janë kryer sipas VKM nr.319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” duke e përshtatur

---

sistemin në rastin e Bashkisë Vlorë, Njesitë administrative Vlorë Qëndër, Novoselë dhe Shushicë.

### **SHERBIMI 1 :“Ngarkim, transport mbeturina“ (16 Ton/dite, 500 kontejnerë)**

Qëllimi i punës: Heqja periodike e mbeturinave nga pikat e grumbullimit me konteniere metalike dhe kosha betoni në njesite administrative Novosele, Qender Vlore dhe Shushice, si dhe transportimi i tyre ne fushën e grumbullimit. Ky shërbim do te kryhet sipas grafikut te shërbimeve ne marrëveshje me sipërmarrësit, duke patur parasysh terrenin e vështire te disa fshatrave.

Pershkrimi i punës:

- a. Mjetet e transportit te mbeturinave sipas destinacionit te caktuar kryejne transportin e mbeturinave nga njesite administrative ne fushën e grumbullimit.
- b. Punëtorët e transportit kane per detyre te heqin te gjithë mbeturinat familjare nga pikat e grumbullimit, te bejne fshirjen me fshese dhe dezinfektimin me gelqere te vend grumbullimit me nje rreze prej 3 ml.
- c. Transporti i mbeturinave nga njesite administrative dhe fshatrat e njesive deri ne fushën e grumbullimit.

Per përpunimin e 16 ton mbeturina jane vendosur ne total 500 konteniere per shkak te shtrirjes se madhe teritoriale te ketyre njesive administrative dhe shperndarjes se popullsisë brenda tyre.

Per heqjen e sasise se mbetjeve prej 16 ton ne dite (5800 ton ne vit), duke u nisur nga eksperiencia e mëparshme ne lidhje me shtrirjen e shërbimit, nevojiten 2 auto teknologjike te kapacitetit deri ne 10 m<sup>3</sup> per arsye se ne zona te caktuara është e pamundur hyrja e automjeteve me kapacitet me te madh se 8-10 m<sup>3</sup>.

Është vene re se makinat teknologjike nuk shkon çdo dite ne cdo fshat per mbledhjen e mbeturinave ne kontejner për shkak sasisë se ulet te gjeneruar te mbetjeve ne kete zona. Mjeti teknologjik lëviz gjithë muajin ne baze te nje grafiku te miratuar me kontraktorin gjate muajit. Pra per efekt analize makineria do ti llogariten shpenzimet per 365 dite. Gjithashtu duke pasur parasysh terrenin dhe shpërndarjen gjeografike te pikave (fshatrave) eshte e domosdoshme nga eksperiencia te planifikohen dhe 1 kamionçine per mbledhjen e mbetjeve (zonat rurale).

### **SHERBIMI 2: “Fshirje e rrugëve dhe shesheve” (84400m<sup>2</sup> / dite)**

Analiza e koston është krijuar mbi bazën e një eksperiencie te gjate te Bashkisë Vlore, duke marre për baze shume elemente te domosdoshem per kete analize te koston.

Tabela e mëposhtme jep koeficientet e llogaritjes se ditëve te punës ne vit për efekt te llogaritjes se pagës ne baze te Kodit te Punës (ore nate, dite pushime, dite festa).

Baza ligjore per hartimin e kesaj tabele:

- Ligj Nr. 7961, Dt 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar me ligjin nr. 9125, date 29.7.2003)
- VKM Nr. 113 Date 01.03.2023 “Per përcaktimin e pages minimale ne shkalle vendi”

Per përcaktimin e normes qe mund te kryej cdo dite nje punojes, sipas *Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020*, per fshirjen manuale percaktohet nje norme 4000-5000 m2/dite per punojes. Gjithsesi bazuar ne eksperiencat e meparshme ne kete analize si norme ditore per punojes do te konsiderohet 5600 m2/dite/punojes

#### 6.1. Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve, Njesia administrative Vlorë Qendër, Novosel, Shushicë

Ky sherbim nenkupton fshirjen e 253 200 m2 trotuare ne 3 dite ne zonat e percaktuara me pare nga autoriteti kontraktor te shperndara si meposhte per cdo njesi administrative.

| Nr | Njësia Administrative | Fshirjem <sup>2</sup> /3ditë | Fshirjem <sup>2</sup> /muaj | Fshirje/vit |
|----|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|-------------|
| 1  | Novoselë              | 220,000                      | 2 200 000                   | 18 000 000  |
| 2  | Qendër                | 30,000                       | 300,000                     | 3 600 000   |
| 3  | Shushicë              | 3,200                        | 32,000                      | 384,000     |
|    | TOTALI                | 253200                       | 2 532 000                   | 30384000    |

Per percaktimin e kosos se fshirjes per 1 m2, do te supozojme sikur fshirja behet cdo dite me siperfaqe ditore  $253200 \frac{m^2}{3dite} / 3 \text{ dite} = 84400 \text{ m}^2/\text{dite}$

|                                |       |                 |
|--------------------------------|-------|-----------------|
| Siperfaqe ditore per tu fshire | 84400 | m2              |
| Norma ditore per punojes       | 365   | Sherbime/vit    |
| Numri i sherbimeve ne vit      | 7000  | m2/dite/punojes |
| Koha e kryerjes se punes       | Diten | 10:00 – 18:00   |

Percaktimi i numrit te punojesve:

Ne baze te normes ditore te percaktuar dhe siperfaqes per fshirje, numri i punojesve do te ishte si me poshte:

Total punetor ne dite =  $84400/7000 = 12 \text{ punetor/dite} \times 1.25 = 15 \text{ punetor}$

---

**Fshirje me fshese =****TABELE PERMBLEDHESE NJESIA NOVOSELE, QENDER, SHUSHICE TE BASHKISE VLORE**

Duke nxjerre shpenzimet për çdo ze pune me poshtë po paraqesim preventivin e plote vjetor

| 1                            | 2                            | 3                    | 4           | 5           | 6       |
|------------------------------|------------------------------|----------------------|-------------|-------------|---------|
| r                            | Përshkrimi i Sherbimeve      | Sasia                | Çmimi Njësi | Çmimi Total | Afati   |
|                              | Ngarkim, transport mbeturina | 5800 t/vit           | -           |             | 12 muaj |
|                              |                              | 60 833 kontenier/vit |             |             |         |
|                              | Fshirje me fshese            | 30384000             | -           |             | 12 muaj |
| <b>Çmimi Neto per 1 vit</b>  |                              |                      |             |             |         |
| <b>TVSH (%) per 1 vit</b>    |                              |                      |             |             |         |
| <b>Çmimi Total per 1 vit</b> |                              |                      |             |             |         |
|                              |                              |                      |             |             |         |

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

#### **Shërbimi që kërkohet:**

#### **Afatet e ekzekutimit:**

“V.O ( Shenim Shpjegues) Ky grafik është hartuar për efekt të sasise së preventivit vjetor që përputhet me atë që është hedhur në SPE on line , si dhe kemi bërë një parashikim mujor të ngarkimit transport të mbeturinave ose plehrave , dhe fshirje me fshese po e njëjta gjë është bërë shpërndarja mujore sipas grafikut.

*Po të vihet re grafiku të cilin ne kemi parashikuar si dhe kemi bërë ndarjen mujore do të peshojë ndryshime sipas shërbimit pastrimit për efekt se jemi dhe në sezon turistik dhe fluksi në bregdet ka rritje të lartë të mbeturinave ,si hotele,restorante,shtëpi private,pallate etj. Theksojmë se ky grafik do të ndryshojë sipas nevojave dhe shërbimit të AK që kanë subjektet,bizneset të fushave të ndryshme etj.Periudhat Maj,Qershor,Korrik,Gusht ,Shtator 2023 do të kenë ngarkesë të lartë ngarkimit transport mbeturinash,jo sipas planit mujor që është bërë shpërndarje vjetore,por shumë herë më e lartë,sipas dhe ekperiencave që kemi pasur kaq vite me pastrimin e qytetit të Vlores.*

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Sherbim pastrimi i njesive administrative Novosele ,Qender Vlore ,Shushice per vitin 2023

## PREVENTIV

**Objekti** Sherbim Pastrimi Njesia Administrative Novosele,Qender Vlore dhe Shushice  
**Fondi**  
**Limit**  
**pa**  
**TVSH :** 31,467,958

| Nr | Pershkrimi I Sherbimeve      | Sasia                 | Cmimi /Njesi | Cmimi Total | Afati   |
|----|------------------------------|-----------------------|--------------|-------------|---------|
| 1  | Ngarkim Transporti Mbeturina | 5800 t/vit            | -            | -           | 12 muaj |
| 2  |                              | 60,833 Kontenier/ vit |              |             |         |
| 3  | Fshirje me fshesë            | 30,384,000            | -            | -           | 12 muaj |
|    | Cmimi Neto per 1 Vit         |                       |              | -           |         |
|    | TVSH 20% per 1 Vit           |                       |              | -           |         |
|    | Cmimi Total per 1 Vit        |                       |              | -           |         |

**Punoi :** V. C Ing

**V.O ( Shenim Shpjegues )**

Ky preventiv eshte hartuar sipas Analizes se Kosmos se detajuar dhe eshte vendosur dhe ndryshimi I cmimit me nr VKM. Nr 113 date 01.03.2023 ,caktimi I pages minimale.

Ne regjister eshte bere shtes ne vlere fondi e cila eshte dhe me K.B (vendim Keshilli Bashkiak).

**Detyrat:** Sherbim pastrimi i njesive administrative Novosele ,Qender Vlore ,Shushice per vitin 2023

Shpërndarja:sipas Grafikut te sherndarjes mujore .

**GRAFIKU I SHERBIM PASTRIM NJESIA ADMINISTRATIVE NOVOSELE,QENDER VLORE ,SHUSHICE:**

mi i njesive  
 osele,Qender  
 vitin 2023'' per  
 a VLORE

| Emri i njesiveve                              | Afati i pastirimit 365 diteose 12muaj (dymebedhete ose treqind e gjashtedehete e pese dite) |              |              |              |              |              |              |              |              |              |              |              | 36           |
|---|---|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
|   | 31 dit  | 31 dit       | 31 dit       | 31 dit       | 31 dit       | 31 dit       | 31dit        | 31dit        | 31 dit       | 31dit        | 31dit        | 31dit        |              |
| <b>SHERBIM ADMINISTRATIVE QENDER SHUSHICE</b> |   |              |              |              |              |              |              |              |              |              |              |              |              |
| Mbeturina                                     | 483.3T  | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       | 483.3T       |
|   | 2,532,000 m2  | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 | 2,532,000 m2 |

V.O ( Shenim Shpjegues) Ky grafik eshte hartuar per efekt te sasise se preventivit vjetor qe perputhet me ate cfare eshte hedhur ne SPE on line , si dhe kemi bere nje parashikim mujor te ngarkim transport te mbeturinave ose plehrave , dhe fshirje me fshese po e njejta gje eshte bere shperndarja mujore sipas grafikut.

*Po te vihet re grafiku te cilin ne kemi parashikuar si dhe kemi bere ndarjen mujore do te pesoje ndryshime sipas sherbim pastrimit per efekt se jemi dhe ne sezon turistik dhe fluksi ne bregdet ka rritje te larte te mbeturinave ,si hotele,restorante,shtepi private,pallate etj. Theksojme se ky grafik do te ndryshoje sipas nevojave dhe sherbimit te AK qe kane subjektet,bisneset te fushave te ndryshme etj.Periudhat Maj,Qershor,Korrik,Gusht ,Shtator dhe Tetor 2023 do kene ngarkese te larte ngarkim transport mbeturinash,jo sipas planit mujor qe eshte bere shperndarje vjetore,por shume here me e larte,sipas dhe ekperienave qe kemi pasur kaq vite me pastrimin e qytetit te Vlores.*

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sherbim pastrimi i njesive administrative Novosele ,Qender Vlore ,Shushice per vitin 2023



## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfitur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

---

## I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 të DT;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.
  - Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi II.8 me qellim pastrimin dhe larjen e konteniereve
  - Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me license D.D.D lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit K II.8.B me qellim dezinfektimin e konteniereve.

Operatori duhet të ketë çertifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata çërkohet të jetë merre të pakten një muaj përpara dates së zhvillimit të tenderit.

Operatori, duhet të ketë çertifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata çërkohet të jetë merre të pakten një muaj përpara dates së zhvillimit të tenderit.

Operatori, duhet të ketë çertifikatën **ISO 45001:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata çërkohet të jetë merre të pakten një muaj përpara dates së zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si më anë të këtij kriteri çërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbimet të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
  - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht **12 (dymbëdhjetë)** persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

| Nr. | Stafi  | Nr.        |
|-----|--|------------|
| 1   | Drejtues Teknik- me profil Menaxhim Mjedisi                  | 1 (një)    |
| 2   | Pergjegjes me profil Menaxhim Mjedisi                        | 1 (një)    |
| 3   | Punonjes sherbimi  | 7 (shtate) |
| 4   | Punonjes sherbimi/Shofer për drejtimin e mjeteve të kërkuara | 3 (tre)    |

|                            |                 |
|----------------------------|-----------------|
